

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.05.2024*

**2.05.2024  
Ora 11:36**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaaj, znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Z. Kristaq Kume, përfaqësues i**

**Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve.**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita, atëherë në seancën e sotme publike, kemi në rendin e ditës këto çështje:

- Shqyrtimin e projektvendimit që ka të bëjë me miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, që është “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Pastaj kemi tre çështje që lidhen me plotësimin e vakancave në këshillat e bashkisë Kamëz, Kavajë dhe Mirëditë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse, sipas

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.05.2024*

kërkesës së paraqitur nga Instituti për Zhvillimin e Sistemeve Zgjedhore. Po zoti Sekretar!

**Z. Y. Merkaç:** Faleminderit! Komiteti përfaqësues i përbërë nga: zoti Kristaq Kume, zonja Olta Qejvani dhe zoti Linert Lirëza, të tre përfaqësues të Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për pajisjen me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Bashkëlidhur kërkesës, është depozituar projektligji që propozohet, relacioni shpjegues i projektligjit, si dhe kopje të kartave të identitetit të përfaqësuesve të nismës. Ky projektligj ka për qëllim të ndryshojë dispozitën e Kodit Zgjedhor për realizimin e objektivave në lidhje me rritjen e mundësive për pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre në kuvend dhe në organet e qeverisjes vendore. Në zbatim të nenit 10 dhe 13, të ligjit “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të miratojë me vendim brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, modelin e fletës tip të mbledhjes së nënshkrimeve dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të KQZ-së, në një format të shkarkueshëm. Gjithashtu duhet të përcaktojë me vendim, sipas propozimit të komitetit përfaqësues, periudhën kohore gjatë të cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, në vendet publike dhe private, si dhe nënshkrimeve elektronike. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! I japim fjalën zotit Kristaq Kume, i cili është dhe vetë themeluesi i kësaj organizate, njëkohësisht dhe përfaqësuesi, për të prezantuar më thelbësisht kërkesën në fjalë!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.05.2024*

**Z. Kristaq Kume:** Përshëndetje të gjithëve! Ju faleminderit zoti Celibashi! Arsyeja pse ne kemi paraqitur këtë kërkesë dhe kemi vendosur që të shfrytëzojmë mundësitë që na jep legjislacioni ynë, për të paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë si zgjedhës të republikës, një projektligj, qëndron në faktin se ne besojmë që mënyra se si është trajtuar kërkesa e Kushtetutës, dispozitat kushtetuese, e cila përcakton dy subjekte në Republikën e Shqipërisë që kanë të drejtën për të propozuar kandidatë për Kuvendin e Shqipërisë, kandidatë për këshillat bashkiakë, ose kryetarë të bashkisë. Këta janë partitë politike dhe qytetarët. Mënyra se si e trajton këtë çështje kushtetuese, Kodi Zgjedhor, në vlerësimin tonë bën që të mos jenë mundësitë e barabarta të këtyre dy subjekteve, të cilët në kuptimin kushtetues nuk kanë asnjë dallim nga njëri-tjetri. Ndërsa partitë politike kanë të drejtë të garojnë me lista zgjedhore, qytetarët kufizohen në të drejtën e tyre për të garuar në proceset zgjedhore. Kodi Zgjedhor përcakton se ata mund të garojnë vetëm me një kandidat, kandidat të pavarur. Ndërkohë ku me kolegët duke e diskutuar këtë problem, midis të tjerave është thënë “po mirë, qytetarët mund të bëhen bashkë dhe propozojnë një kandidat, mund të bëhen të tjerë qytetarë dhe të propozojnë një tjetër kandidat, e kështu me rradhë”. Duket sikur problemi nuk ka difekt në fakt në barazinë që duhet të ketë, qoftë dhe në barazinë proporcionale që duhet të ketë, ushtrimi i të drejtës për të propozuar kandidatë midis partive politike dhe qytetarëve. Efekti i kësaj mënyre të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, i cili nuk e kufizon, pra mund të kemi dy, tre, pesë kandidatë të pavarur në një njësi zgjedhore është i qartë duke pasur parasysh mënyrën se si votat e fituara kthehen në mandat. Në qoftë se në një zonë zgjedhore kandidojnë tre kandidatë të pavarur dhe secili prej tyre merr, po themi, katër mijë vota. Asnjëri prej tyre nuk merr mandat. Ama në qoftë se ata garojnë së bashku me listë zgjedhore, janë dymbëdhjetë mijë vota që merr kjo listë zgjedhore. Kjo do të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.05.2024*

thotë që e prodhojnë patjetër një kandidat. Mjafton ky arsytim që të justifikojë përpjekjen që ne bashkë me qytetarët do të bëjmë për të realizuar këtë mundësi, e cila përmbledhet fare thjesht me një fjalë “e drejta e qytetarëve për të garuar me listë zgjedhore dhe jo vetëm me një kandidat”. Kjo listë zgjedhore mund të ketë një kandidat, ose më shumë kandidatë. Natyrisht lista zgjedhore dhe kjo e drejtë e qytetarëve nuk ka pse të kërkohet që të jetë e barazvlefshme për nga detyrimet që duhet të kenë qytetarët nga ato që kanë partitë politike. Siç dihet partitë politike në qoftë se garojnë, duhet të garojnë në 12 njësitë zgjedhore, në të njejtën kohë dhe në qoftë se garojnë duhet ta bëjnë këtë me listë zgjedhore me numër të barabartë (+ - kemi parasysh atë 2-shin) në të gjitha njësitë zgjedhore, aq sa janë kandidatët ku bëhen zgjedhjet për njësinë përkatëse zgjedhore. Qytetarëve nuk ka pse t’u vihet një kusht i tillë. Qytetarët mund të garojnë me një listë zgjedhore vetëm në një njësi zgjedhor me një, dy, tre, pesë kandidatë dhe në qoftë se do të pranohet, patjetër që jemi të detyruar të pasqyrojmë atë që Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim në lidhje me administrimin e votës parapëlqyese. Propozimi ynë, ato që ne kemi depozituar këtu te ju është i tillë që mund të garohet me listë kandidatësh të pavarur, e hapur 100%. Në këtë mënyrë ne mendojmë se veçanërisht duke ju referuar situatave, kushteve, mënyrës se si ne si shoqëri e ushtrojmë demokracinë, mendojmë se në këtë mënyrë do të krijojmë hapsira më të mira, shumë më funksionale se këto që kemi për t’i bërë qytetarët pjesë të vendimmarrjes jo vetëm duke votuar për kandidatët që ju ofrojnë partitë politike, por dhe për ata njerëz që ata duan. Në se do të arrihet një gjë e tillë, ne nuk do të kemi më situata si ato që kemi kaluar deri më sot, ku në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë ka, ose s’ka një apo dy kandidatë të pavarur në të gjithë Shqipërinë, por do të kemi një numër të mirë kandidatësh të pavarur dhe prej tyre një pjesë e mirë deputetë në Kuvendin e Shqipërisë. Nuk ka pse të kemi aq pak kandidatë të pavarur në këshillat bashkiakë siç praktikisht i kemi. Natyrisht unë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.05.2024*

e kuptoj mirë se çdo të thotë t'u kërkosh partive politike një gjë të tillë. Për ne, kjo nuk do të thotë gjë fare, përkundrazi është një faktor më shumë që na nxit të mobilizohemi akoma më tepër për të realizuar atë që ka të bëjë me mirfunksionimin e demokracisë përfaqësuese. Kjo me të drejtën që kemi për të qenë ne (qytetarët), sovranët në kuptimin e asaj që instuticionet që do të na qeverisin të kenë në përbërjen e tyre, të jenë të formuara si rezultat i një pjese të mirë të tyre prej vullnetit tonë. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Kume! Besoj se shpjegimi juaj e qartësoi se ku konsiston ndryshimi i kërkuar në Kodin Zgjedhor, po ashtu dhe arsyetimi se pse kërkohet ky ndryshim. Në tërësi vlerësojmë se kërkesa juaj për të realizuar procesin e mbledhjes së nënshkrimeve gjen mbështetje në ligj dhe ne vendosim ta miratojmë fletën tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas modelit që tashmë pak a shumë është i njohur për të gjithë. Mirë faleminderit!

**Vendimi nr. 42**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

**Projektvendime: “Për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Z. Kristaq Kume, përfaqësues i**

**Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve.**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës, po!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Këshillat e Bashkisë: Kamëz, Kavajë dhe Mirëditë, kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave nga këshilltarët e tyre. Kandidatët vijues nga listat shumemërore të partive përkatëse që ju kalon mandati i këshilltarit, kanë plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se asnjë prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e tre kandidatëve, ku konstatohet se kandidatët nuk janë të

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 02.05.2024*

dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatëve për anëtar të Këshillit e Bashkisë: Kamëz, Kavajë dhe Mirëditë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë atëherë, miratojmë:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kamëz, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zotin Dritan Bresa.
  - Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, zotin Enea Stefa.
  - Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirëditë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate, zotin Nikolin Luli.
- Çështje të tjera nuk kemi, mire faleminderit! Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimet nr. 43, 44, 45.**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

